



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2352 Prot

Shkodër, me 20.08 2026

V E N D I M

Nr. 232 datë 20 . 08 . 2026

**"PËR MIRATIMIN E PROJEKT-BUXHETIT AFATMESEM PER PERIUDHEN
2027-2029 PER UNIVERSITETIN E "LUIGJ GURAKUQI" SHKODER**


Bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 38,pika 1,germa h; Statutin e Ush-se, neni 17, pika 6 germa c; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e finaciare dhe kontrollin "(i ndryshuar); VKM nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor"; Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 "Mbi përgaditjen e programit buxhetor afatmesëm"; udhëzimi plotësues nr.4 datë 24.01.2025; Shkresës së Ministrisë së Arsimit nr.2726prot datë 17.07.2026"Mbi përgaditjen e programit buxhetor afatmesëm";Relacioni mbi hartimin e projekt buxhetit afatmesëm për periudhën 2027-2029" me vendim të Senatit Akademik të USH-së nr.225 datë 18.08.2026, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt-buxhetin afatmesëm për periudhën 2027-2029 të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i USH për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Prof. Asoc. Dr. Adrian LEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

ADMINISTRATORI

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____, 2026

Lënda: Relacion mbi hartimin e projektit të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2027-2029 për Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër

SENATIT AKADEMIK
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR
REKTORIT PROF.DR. BLERTA DRAGUSHA
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, veçanërisht të neneve 49 dhe 52; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 "Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm"; standarteve të përcaktuara në udhëzimin nr. 15 datë 07.07.2026 të Ministrisë të Financave "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029", të neneve 28, 36 dhe 71 të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", paraqitet projektbuxhetit afatmesëm për periudhën 2027-2029 për Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër.

Ky relacion paraqitet për shqyrtim në Senatin Akademik, me qëllim informimin mbi metodologjinë e ndërtimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, prioritetet financiare të planifikuara për periudhën 2027-2029, si dhe marrjen e vendimit për miratimin e tij, përpara përcjelljes pranë Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është hartuar në kuadër të procesit të planifikimit strategjik dhe financiar të institucionit, me synim sigurimin e një administrimi të qëndrueshëm të burimeve financiare dhe mbështetjen e zhvillimit të veprimtarisë akademike, kërkimit shkencor dhe investimeve institucionale gjatë periudhës afatmesme.

Hartimi i këtij projektbuxheti është mbështetur në analizën e realizimit të pritshëm të buxhetit të vitit 2026, nevojat e paraqitura nga njësitë kryesore dhe bazë të Universitetit, objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit, si dhe në prioritetet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029. Procesi i hartimit është zhvilluar në bashkëpunim me fakultetet, njësitë administrative dhe strukturat përgjegjëse të Universitetit, të cilat kanë paraqitur kërkesat dhe projektet e tyre prioritare, të analizuara më pas në funksion të mundësive reale të financimit, prioritetëve institucionale dhe objektivave të zhvillimit afatmesëm.

Projektbuxheti është konceptuar mbi parimet e eficiencës, efektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike, duke synuar ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, modernizimin e infrastrukturës universitare, si dhe zgjerimin e shërbimeve në funksion të studentëve dhe stafit akademik.

OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027–2029


Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 është hartuar në funksion të realizimit të misionit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", duke synuar garantimin e një administrimi financiar të qëndrueshëm dhe mbështetjen e zhvillimit institucional në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit dhe prioritetet kombëtare për arsimin e lartë.

Projektbuxheti është orientuar drejt financimit të aktiviteteve dhe investimeve që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, fuqizimin e kërkimit shkencor, modernizimin e infrastrukturës universitare, zhvillimin e shërbimeve digjitale dhe rritjen e

bashkëpunimit ndërkombëtar, duke siguruar njëkohësisht vazhdimësinë e funksionimit normal të institucionit.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si dhe me prioritetet kombëtare për arsimin e lartë, Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 synon realizimin e këtyre objektivave kryesore:

- ✓ **Garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarisë akademike**, nëpërmjet sigurimit të burimeve financiare të nevojshme për realizimin e misionit të Universitetit.
- ✓ **Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor**, duke krijuar kushte bashkëkohore për zhvillimin e procesit akademik, laboratorëve dhe veprimtarisë kërkimore.
- ✓ **Mbështetjen e njësive akademike dhe administrative**, nëpërmjet financimit të prioritetëve dhe nevojave të paraqitura nga fakultetet dhe strukturat përkatëse.
- ✓ **Përmirësimin e infrastrukturës universitare dhe ambienteve mësimore**, me synim krijimin e kushteve më të mira për studentët, stafin akademik dhe administrativ.
- ✓ **Përmirësimin e shërbimeve studentore**, duke investuar në lehtësirat, mjediset dhe kushtet që ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën akademike të studentëve.
- ✓ **Forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore**, nëpërmjet mbështetjes së kualifikimit të stafit akademik, kërkuesve të rinj, pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe aplikimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare.
- ✓ **Mbështetjen e proceseve të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit institucional**, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✓ **Zhvillimin e transformimit digjital të Universitetit**, duke zgjeruar përdorimin e teknologjive të informacionit dhe inteligjencës artificiale në proceset akademike dhe administrative.
- ✓ **Rritjen e ndërkombëtarizimit të Universitetit**, nëpërmjet zhvillimit të programeve të përbashkëta dhe të dyfishta të studimit, ofertës akademike në gjuhë të huaj, mobilitetit të studentëve dhe stafit, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë.
- ✓ **Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative**, nëpërmjet zhvillimit



profesional të personelit, përmirësimin të proceseve të menaxhimit dhe administrimit, si dhe konsolidimit të strukturave në funksion të rritjes së performancës institucionale.

- ✓ **Garantimin e një administrimi financiar të përgjegjshëm dhe transparent,** duke siguruar përdorimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike dhe të ardhurave të institucionit.

Realizimi i këtyre objektivave mbështetet në një planifikim financiar realist, të bazuar në analizën e realizimit të buxhetit të vitit 2026, nevojat e paraqitura nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe kufijtë orientues të financimit të përcaktuar nga institucionet përgjegjëse.

PROFILI I UNIVERSITETIT DHE TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË

Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 është hartuar mbi bazën e analizës së situatës aktuale të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", duke marrë në konsideratë strukturën organizative, kapacitetet akademike dhe administrative, numrin e studentëve, si dhe nevojat për financimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe zhvillimore.

Analiza e këtyre treguesve ka shërbyer si bazë për përcaktimin e prioritetëve financiare dhe shpërndarjen e burimeve në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.

Organizimi institucional

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet Rektoratit, gjashtë fakulteteve dhe njësisë mbështetëse akademike e administrative, të organizuara sipas strukturës së miratuar nga organet drejtuese të Universitetit.

Veprimtaria akademike zhvillohet nëpërmjet:

1. Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
2. Fakultetit të Shkencave Shoqërore;
3. Fakultetit të Drejtësisë;
4. Fakultetit të Shkencave të Edukimit;
5. Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
6. Fakultetit Ekonomik;

si dhe njësitë kërkimore dhe strukturave administrative që mbështesin realizimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve.

✓ **Struktura organizative e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

Niveli organizativ	Njësitë
Organe drejtuese	Senati Akademik, Bordi i Administrimit.
Drejtimi ekzekutiv	Rektori, Zëvendësrektorët, Administratori
Njësitë kryesore	Fakulteti i Shkencave të Natyrës; Fakulteti i Shkencave Shoqërore; Fakulteti i Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave të Edukimit; Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; Fakulteti Ekonomik
Njësitë kërkimore	Qendra Kërkimore e Albanologjisë; Qendra e Studimit të Ujërave në Rajonin e Shkodrës
Njësitë mbështetëse	Biblioteka Universitare, Njësitë ndihmëse akademike dhe Strukturat administrative

✓ **Profili i Universitetit**

Tregues	Vlera
Fakultete	6
Qendra kërkimore	2
Studentë (Cikli I)	2,620
Studentë (Cikli II)	1,210
Studentë (Cikli III)	44
Personel akademik	223
Personel administrativ dhe ndihmës akademik	139

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" vijon të përfaqësojë institucionin kryesor publik të arsimit të lartë në rajonin verior të vendit, duke ofruar programe studimi në fusha të ndryshme të shkencave natyrore, shoqërore, juridike, ekonomike, të edukimit dhe gjuhëve të huaja. Shtrirja e ofertës akademike, numri i studentëve dhe kapacitetet njerëzore e infrastrukturore përbëjnë bazën mbi të cilën është ndërtuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029.


Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ofron një gamë të gjerë programesh studimi në të tre cikletë e arsimit të lartë, si dhe programe me karakter profesional dhe të formimit të vazhduar. Oferta akademike zhvillohet në gjashtë fakultetet e Universitetit dhe përditësohet në vijimësi në përputhje me zhvillimet akademike, kërkesat e tregut të punës dhe prioritetet institucionale.

OFERTA AKADEMIKE

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"



Në kuadër të zhvillimit të ofertës akademike dhe përshtatjes së saj me nevojat e tregut të punës, prioritetet e zhvillimit institucional dhe standardet e arsimit të lartë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka zgjeruar dhe riorganizuar ofertën e programeve të studimit për vitin akademik 2026–2027. Programet e miratuara përfshijnë programe të reja studimi, programe të riorganizuara dhe programe të përditësuara, të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.



Cikli i studimit	Programi i studimit	Statusi
Bachelor	Gjuhë dhe kulturë angleze e amerikane	Riorganizim
Bachelor	Gjuhë dhe kulturë italiane dhe mesdhetare	Riorganizim
Bachelor	Bachelor in Business Administration	Program i ri
Master i Shkencave	Hulumtime mbi etnokulturën dhe letërsinë shqipe	Program i ri
Master i Shkencave	Gjuhësi	Program i ri
Master i Shkencave	Psikologji Ligjore	Program i ri
Master Profesional	Redaktori	Program i ri
Program karakter profesional	Gjuhë gjermane dhe operator sanitar	Program i ri

Hapja dhe riorganizimi i këtyre programeve përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm të ofertës akademike të Universitetit, duke reflektuar angazhimin për përshtatjen e programeve të studimit me zhvillimet bashkëkohore të arsimit të lartë, nevojat e tregut të punës dhe prioritetet strategjike të institucionit. Këto programe kontribuojnë në zgjerimin e ofertës akademike, rritjen e konkurrueshmërisë së Universitetit dhe forcimin e rolit të tij në zhvillimin ekonomik e shoqëror të rajonit dhe të vendit.

Pas përcaktimit të objektivave strategjike dhe prioriteteve institucionale, Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 materializohet në planifikimin financiar të burimeve dhe përdorimin e tyre sipas kategorive ekonomike të buxhetit.

Struktura financiare e Programit është ndërtuar mbi analizën e realizimit të buxhetit të viteve paraardhëse, realizimin e pritshëm të vitit 2026, nevojat e paraqitura nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe kufijtë orientues të financimit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave. Në këtë mënyrë është synuar që fondet publike dhe të ardhurat e institucionit të shpërndahen në funksion të prioriteteve strategjike, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në administrimin e tyre.

Në vijim paraqitet analiza e detajuar e Programit Buxhetor Afatmesëm, e organizuar sipas kategorive kryesore ekonomike të të ardhurave, shpenzimeve korrente dhe investimeve kapitale, me qëllim evidentimin e strukturës së financimit, tendencës së planifikimit dhe ndikimit të secilit zë në realizimin e objektivave të zhvillimit të Universitetit.

ORIENTIMET KYESESORE TË ZHVILLIMIT PËR PERIUDHËN 2027–2029

Në vijim të analizës së treguesve institucionalë, nevojave të evidentuara nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe objektivave strategjike të Universitetit, Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 është orientuar drejt financimit të prioritetëve që garantojnë funksionimin normal të institucionit dhe mbështesin zhvillimin e tij afatgjatë. Planifikimi buxhetor është ndërtuar mbi parimin e balancimit ndërmjet mbulimit të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin e Universitetit dhe financimit të nismave që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, zhvillimin e kërkimit shkencor, modernizimin e infrastrukturës dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për periudhën 2027–2029, orientimet kryesore të zhvillimit janë:

✓ Mbështetja e veprimtarisë akademike

Sigurimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, përditësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe mbështetjen e ofertës akademike ekzistuese dhe programeve të reja të studimit.

✓ Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit

Rritja e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor, pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, mobilitetin akademik, organizimin e konferencave shkencore dhe zgjerimin e bashkëpunimit me universitete e institucione partnere.

✓ Digjitalizimi dhe modernizimi i administrimit

Vijimi i procesit të digjitalizimit të shërbimeve universitare, zhvillimi i sistemeve të administrimit elektronik, përdorimi i teknologjive të reja dhe inteligjencës artificiale në proceset akademike dhe administrative, si dhe rritja e sigurisë së infrastrukturës informatike.

✓ Përmirësimi i infrastrukturës universitare

Realizimi i investimeve për mirëmbajtjen dhe modernizimin e godinave universitare.

laboratorëve, auditorëve dhe ambienteve në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor dhe krijimi i kushteve më të mira për studentët dhe stafin.

Zhvillimi institucional

Forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet zhvillimit profesional të stafit akademik dhe administrativ, përmirësimit të proceseve të menaxhimit dhe konsolidimit të strukturave mbështetëse, me synim rritjen e performancës dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Planifikimi financiar synon të garantojë mbështetjen e veprimtarisë akademike dhe kërkimore, përmirësimin e infrastrukturës universitare, zhvillimin e shërbimeve studentore, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vijimin e proceseve të digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit. Shpërndarja e fondeve është realizuar duke respektuar parimet e ligjshmërisë, ekonomicitetit, eficiencës, efektivitetit dhe transparencës në administrimin e fondeve publike, me synim përdorimin sa më racional të burimeve financiare në dispozicion.

Në vijim paraqitet përmbledhja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, e cila pasqyron në mënyrë sintetike strukturën e financimit dhe drejtimit kryesor të përdorimit të fondeve, ndërsa analizat e detajuara sipas kategorive të të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve paraqiten në seksionet pasuese të këtij relacioni.

Fusha prioritare	Synimi kryesor	Burimi i financimit
Veprimtaria akademike	Garantimi i procesit mësimor	Grant + të ardhura
Kërkimi shkencor	Projekte dhe mobilitet	Grant + projekte
Infrastrukturë	Investime dhe mirëmbajtje	Grant + investime
Digjitalizimi	Sisteme informatike	Grant + të ardhura
Administrimi	Mbështetja e strukturave	Grant

ANALIZA E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029

Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 është ndërtuar duke respektuar kufijtë orientues të financimit, analizën e realizimit të buxhetit të vitit 2026, nevojat e paraqitura nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe prioritetet strategjike të Universitetit. Struktura e projektbuxhetit pasqyron shpërndarjen e burimeve financiare sipas kategorive kryesore të të ardhurave, shpenzimeve korrente dhe investimeve, me synim garantimin e funksionimit normal të institucionit dhe mbështetjen e zhvillimit të tij afatgjatë.

Analiza e të ardhurave

Të ardhurat e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" krijohen kryesisht nga tarifat e studimit në ciklet e ndryshme të arsimit të lartë, tarifat dhe shërbimet administrative, veprimtaritë dytësore të institucionit, si dhe burime të tjera të ligjshme. Pjesën kryesore të të ardhurave e përbëjnë tarifat e shkollimit të ciklit të parë, të ndjekura nga të ardhurat nga programet Master i Shkencave dhe Master Profesional. Një kontribut të rëndësishëm japin gjithashtu të ardhurat nga shërbimet dhe veprimtaritë dytësore, programet e doktoraturës dhe tarifat administrative. Kjo strukturë tregon se kapaciteti i Universitetit për të gjeneruar të ardhura lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprimtarinë akademike dhe zhvillimin e ofertës së programeve të studimit.

Struktura e të ardhurave të institucionit – Fakt 2025

Burimi i të ardhurave	Vlera (lekë)	Pesha
Tarifat e shkollimit	47,151,000	47.49%
Master i Shkencave	24,060,000	24.23%
Master Profesional	16,440,000	16.56%
Të tjera sekondare dhe pagesa shërbimesh	9,594,000	9.66%
Të ardhura të tjera	2,045,303	2.06%
TOTALI	99,290,303	100%

Siç evidentohet në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i të ardhurave të Universitetit gjatë


vitit 2025 i cila qonë tarifat e shkollimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat përbëjnë rreth 47.5% të të ardhurave të institucionit. Programet e ciklit të dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) kontribuojnë më rreth 40.8% të totalit, duke dëshmuar rëndësinë e tyre në strukturën e financimit të Universitetit. Pjesa tjetër e të ardhurave sigurohet nga tarifat administrative, shërbimet dhe veprimtaritë e tjera të institucionit.

Parashikimi i të ardhurat 2027-2029

Parashikimi i të ardhurave për periudhën 2027–2029 është ndërtuar mbi analizën e realizimit të viteve paraardhëse, realizimin e pritshëm të vitit 2026 dhe projeksionet e Programit Buxhetor Afatmesëm. Planifikimi pasqyron një ecuri të qëndrueshme të të ardhurave, duke garantuar mbështetjen financiare të veprimtarisë së Universitetit dhe realizimin e objektivave strategjike të tij gjatë periudhës afatmesme.

Planifikimi i të Ardhurave të Universitetit 2025-2029

2025	2026	2027	2028	2029
99.290	101.094	102.504	103.360	104.547
Fakt	I pritshmi	Planifikuar	Planifikuar	Planifikuar



Të ardhurat e paraqitura në këtë seksion përfaqësojnë vetëm të ardhurat e veta të Universitetit. Buxheti i përgjithshëm i institucionit për periudhën 2027–2029 do të financohet nga kombinimi i të ardhurave të veta dhe grantit buxhetor të akorduar nga Buxheti i Shtetit, i cili përbën burimin kryesor të financimit të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative.

Shpenzimet e planifikuara për periudhën 2027-2029 janë ndërtuar në funksion të garantimit të vazhdimësisë së veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative të Universitetit, duke respektuar kufijtë orientues të financimit dhe prioritetet strategjike të institucionit. Planifikimi është bazuar në analizën e realizimit të viteve të mëparshme, nevojat e paraqitura nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe objektivat e zhvillimit institucional.

Shpenzimet për personelin (Art. 600 dhe 601)

Shpenzimet për personelin përbëjnë zërin kryesor të buxhetit të Universitetit dhe janë të orientuara drejt garantimit të zhvillimit normal të procesit akademik dhe administrativ. Kjo kategori përfshin shpenzimet për paga (artikulli 600) dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (artikulli 601), të planifikuara në përputhje me strukturën organizative të miratuar, numrin e punonjësve të planifikuar dhe kuadrin ligjor në fuqi. Planifikimi i këtyre shpenzimeve është mbështetur në analizën e realizimit të viteve të mëparshme, nevojat reale të njësive akademike dhe administrative, si dhe politikat e pagave të miratuara për institucionet publike të arsimit të lartë. Qëllimi kryesor është garantimi i burimeve njerëzore të nevojshme për përmbushjen e misionit të Universitetit dhe ruajtja e qëndrueshmërisë financiare gjatë gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Në mijë lekë

Përshkrimi	2025 Fakt	2026 Plan	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA
Art. 600 Paga	571,602	580,000	673,670	678,000	680,000
Art. 601 Sigurime shoqërore	88,699	90,000	104,121	105,000	110,000
Totali	660,301	670,000	777,791	783,000	790,000

Shpenzimet për personelin përbëjnë zërin më të madhe në buxhetin e Universitetit dhe përfshijnë fondin e pagave (art.600) dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (art.601). Planifikimi i tyre është hartuar në funksion të garantimit të zhvillimit normal të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative, duke u bazuar në strukturën organizative të miratuar, numrin e punonjësve të planifikuar dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Për periudhën 2027-2029 parashikohet një rritje e fondit të personelit, e lidhur me zbatimin e politikave të pagave në sektorin publik, përmbushjen e detyrimeve ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe nevojën për të garantuar kapacitetet njerëzore të domosdoshme për realizimin e misionit të Universitetit.

Shpenzimet operative (Art. 602)

Shpenzimet operative (artikulli 602) përfaqësojnë fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të funksionimit të përditshëm të Universitetit. Kjo kategori përfshin shpenzimet për mallra dhe shërbime, mirëmbajtjen e godinave dhe pajisjeve, furnizimet, shërbimet komunale, shërbimet e komunikimit, shpenzimet për veprimtarinë akademike dhe administrative, si dhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për garantimin e funksionimit normal të institucionit. Planifikimi është bazuar në analizën e realizimit të viteve të mëparshme, nevojat e paraqitura nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe prioritetet e përcaktuara në Programin Buxhetor Afatmesëm.

Në mijë lekë

Përshkrimi	2025	2026	2027	2028	2029
	Fakt	Plan	PBA	PBA	PBA
Materiale zyre dhe të përgjithshme	3,164	8,220	8,265	8,503	8,675
Materiale dhe shërbime speciale	1,665	10,040	5,661	6,196	6,500
Shërbime nga të tretët	51,373	55,244	79,609	84,500	83,849
Shpenzime transporti	156	1,150	504	529	556
Shpenzime udhëtimi	11,664	8,200	12,460	12,933	13,520
Mirëmbajtje e zakonshme	12,090	21,140	17,210	17,351	17,912
Qeramarrje	250	0	1,200	1,300	1,300
Shpenzime të tjera operative	21,617	38,900	32,412	33,370	34,270
TOTALI	101,978	142,894	157,321	164,682	166,581

Objektet e planifikuara në artikullin 604 - Transferat korrente janë të orientuara drejt mbështetjes së organizatave jo-fitimprurëse që zhvillojnë veprimtari në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Këto fonde shërbejnë kryesisht për mbështetjen e klubeve sportive universitare, shoqatave studentore dhe organizmave të tjerë jo-fitimprurës, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e jetës studentore, promovimin e sportit universitar, aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore, si dhe në përfaqësimin e Universitetit në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përshkrimi	Në mijë lekë				
	2025	2026	2027	2028	2029
	Fakt	Plan	PBA	PBA	PBA
Transferime organizata jo-fitimprurëse	732	1,000	1,000	1,000	1,000
TOTALI	732	1,000	1,000	1,000	1,000

Transferatat për buxhetet familjare dhe individët (Art. 606)

Transferatat për buxhetet familjare dhe individët përfshijn fondet e planifikuara për mbështetjen financiare të studentëve dhe individëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat sociale të Universitetit. Pjesën kryesore të këtij artikulli e zënë fondet për bursa studentore, të cilat synojnë të mbështesin studentët përfitues sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në këtë artikull janë planifikuar gjithashtu fondet për pagesat që lidhen me daljen në pension të punonjësve, si dhe ndihmat financiare në raste fatkeqësish ose situatash të veçanta, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të Universitetit.

Përshkrimi	Në mijë lekë			
	2026 Plan	2027 PBA	2028 PBA	2029 PBA
Kompensim individe (pension)	258	258	258	258
Transferatat për individët dhe bursa	59,130	60,930	62,730	64,530
TOTALI	59,388	61,188	62,988	64,788

Planifikimi për periudhën 2027-2029 synon garantimin e mbështetjes financiare për këto kategori përfituesish dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në

fuqi.

Shpenzimet/kapitale (Art. 231) – Investimet

Përveç shpenzimeve korrente, Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 parashikon edhe fondet për investime kapitale (Art.231), të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës universitare, modernizimin e ambienteve mësimore dhe laboratorike, rritjen e kapaciteteve institucionale, si dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve. Investimet janë planifikuar në përputhje me prioritetet strategjike të Universitetit, nevojat e evidentuara nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe mundësitë reale të financimit gjatë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm. Nëpërmjet këtyre investimeve synohet ruajtja dhe zhvillimi i aseteve universitare, rritja e cilësisë së infrastrukturës dhe krijimi i një mjedisi bashkëkohor që mbështet procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit institucional.

Në mijë lekë

Prioriteti strategjik	2026	2027	2028	2029
Modernizimi i infrastrukturës universitare (kalldaja, çati, kabinë elektrike, projektine, mbikëqyrje, kolaudime, investime të pritshme të fakulteteve)	33,610	15,204	13,500	15,000
Digjitalizimi dhe pajisjet (pajisje elektronike, inventar, kondicionerë, perde, automjet, roll-up, baner, stola)	37,500	30,300	27,800	22,800
Laboratorët, bibliotekat dhe mjediset mësimore (laboratorë, libra, pajisje për palestër, tela pianoje)	9,718	9,219	900	2,200
Mbështetja e projekteve ndërkombëtare (TVSH e projekteve)		2,000	2,000	2,000
TOTALI	80,828	56,723	43,700	42,000

Programi i investimeve për periudhën 2027–2029 është orientuar drejt modernizimit të infrastrukturës universitare, pajisjes së laboratorëve dhe ambienteve mësimore, përmirësimit të bazës materiale dhe mbështetjes së projekteve zhvillimore të Universitetit. Peshën kryesore të investimeve e zënë ndërhyrjet në infrastrukturë dhe pajisjet elektronike, të cilat krijojnë kushtet për përmirësimin e cilësisë së procesit akademik, rritjen e kapaciteteve kërkimore

dhe zhvillimit afatgjatë të institucionit.

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029

DËR


Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmblëdhur planifikimin e kategorive kryesore të shpenzimeve për periudhën 2026-2029, duke evidentuar evolucionin e tyre gjatë gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Kategoria e shpenzimeve	Në mijë lekë			
	2026	2027	2028	2029
(600/601) Paga Personeli	670,000	777,791	783,000	790,000
(602) Shpenzime operative	142,894	157,321	164,682	166,581
(604) Transferta korrente	1,000	1,000	1,000	1,000
(606) Bursa dhe transferta për individë	59,388	61,188	62,988	64,788
(231) Investime kapitale	80,828	56,723	43,700	42,000
TOTALI	954,110	1,054,023	1,055,370	1,064,369

Në përfundim të analizës së secilit grup shpenzimesh, grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur strukturën financiare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029. Kjo përmblëdhje eidenton shpërndarjen e fondeve sipas kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve.

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2027

ËR



Personeli (600+601)	777,791 mijë lekë	73.8%	Investime (231)	56,723 mijë lekë	5.4%
Shpenzime operative (602)	157,321 mijë lekë	14.9%	Transferata korrente (604)	1,000 mijë lekë	0.1%
Bursa dhe transferata (606)	61,188 mijë lekë	5.8%			


Vlerat dhe përqindjet janë llogaritur mbi totalin e planifikuar për vitin 2027.

PËRFUNDIME

Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, kufijtë orientues të financimit dhe prioritetet strategjike të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Planifikimi financiar pasqyron nevojat reale të institucionit, duke synuar garantimin e vazhdimësisë së veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative, si dhe mbështetjen e investimeve prioritare për zhvillimin e Universitetit.

Projektbuxheti është ndërtuar mbi parimet e ligjshmërisë, ekonomikitetit, eficiencës, efektivitetit dhe transparencës në administrimin e fondeve publike, duke synuar përdorimin racional të burimeve financiare dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit përgjatë gjithë periudhës së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Për sa më sipër, propozohet që Senati Akademik të shqyrtojë dhe të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", me qëllim vijimin e procedurave për përcjelljen e tij pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.



ADMINISTRATORI

Mark Molla

PROJEKT BUXHETI AFATMESEM (PBA) Viti 2027 - 2029

Viti 2027

Ministria/ Institucioni Kodi 1011129 Pershkrimi Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"

Idlir Bekteshi

Drejtori i Drejtorise Ekonomike Nepunesi Zhatues

MARK MOLLA

Koordinatori i GSH/ Nepunesi Autorizues - Administrator



PROJEKT BUXHETI AFATMESEM (PBA)	
Viti 2027-2029	
Ministria/ Institucioni	Kodi 1011129
Pershkrimi Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"	
Shkruaj Emri mbiemri	Drejtori i Drejtorise Ekonomike Nepunesi Zhatues Idlir Bekteshi
Shkruaj Emri mbiemri	Koordinatori i GSH/ Nepunesi Autorizues - Administrator MARK MOLLA

[Faint handwritten notes or bleed-through from the reverse side of the page]

[illegible]

PBA 2025-2027
Viti 2027
Ne 000 leke

Kodi	Pershkrimi
101129	Universiteti Luigj Gurakuqi

Grupi	Titulli	Kapitulli	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
			Pagat	Kontab. e Sigurimeve Shqiptore	Madira dhe Shërbime	Subvencione	Te Ftera Transfer. Korrente Brendshine	Transfer. Korrente te Huaja	Transferata per Buxhetet Familjare dhe Individet	Shpenzime Kapitale te Paternezoara	Shpenzime Kapitale te Empezoara	
<<Ministria e...>>												
01110	1 <<PLANIFIKIM MENAXHIUM>>		673.670	104.670	119.547	0	0	0	61.188	0	0	959.075
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
09120	2 <<Arsimi Baze +Parashkollori 09120 >>		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem											0
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
09230	3 <<Arsimi i Mesem i Pergjithshem 09230 >>		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem											0
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
09450	4 <<Arsimi i Larte 09450 >>		673.670	104.670	119.547	0	0	0	61.188	0	0	959.075
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem		673.670	104.670	119.547				61.188			959.075
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
09770	5 <<Kerklami Shkenor 09770>>		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem											0
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
08140	6 <<Programi i Sportit >>		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Pergjithshem											0
	2 Financim i Huaj											0
	3 Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj											0
	4 Mblidhimi i TVSH. Derivimeve Doganore											0
	5 Shpenzime nga te Ardhatat											0
	6 Shpenzime nga te Ardhatat jashte limitit											0

Financim i Drejtorise Ekonomike Finances	Financim i Huaj	Financim i Huaj
Financim i Huaj	Financim i Huaj	Financim i Huaj
Financim i Huaj	Financim i Huaj	Financim i Huaj



Ministria/Institucioni Buxhetor/Grupi		Kodi		Përshkrimi								
1011129		Universiteti Luigj Gurakuqi										
Grupi	Titulli Kapitulli	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali	
		Paga	Kontrib. e Sigurimeve Shqiptare	Mallra dhe Shërbime	Solvent-imet	Të Tjera Transfer. Korrente të brendshme	Transfer. Korrente të tjera	Transfer. Familjare dhe Individuale	Shpenzime Kapitale të Përmirësimit	Shpenzime Kapitale të Transferimit		
<<Ministria e...>>												
01110	1 <<PLANIFIKIM MENAXHIM>>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm											
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
	4 Mbledhjet dhe TVSH, Detyrimeve Doganore											
	5 Shpenzime nga të Ardhurat											
09120	2 <<Arsimi Bazë +Parshkollori>>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm											
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
	4 Mbledhjet dhe TVSH, Detyrimeve Doganore											
	5 Shpenzime nga të Ardhurat											
09230	3 <<Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm>>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm											
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
	4 Mbledhjet dhe TVSH, Detyrimeve Doganore											
	5 Shpenzime nga të Ardhurat											
09450	4 <<Arsimi i Mesëm i Lartë>>	678,000	105,000	125,000	0	0	0	62,988	0	0	970,988	970,988
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm	678,000	105,000	125,000				62,988				
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
	4 Mbledhjet dhe TVSH, Detyrimeve Doganore											
	5 Shpenzime nga të Ardhurat											
09770	5 <<Arsimi i Lartë>>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm											
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
	4 Mbledhjet dhe TVSH, Detyrimeve Doganore											
	5 Shpenzime nga të Ardhurat											
08140	6 <<Sporti dhe Rina>>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm											
	2 Financim i Huaj											
	3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj											
